

## **Thirrje për Pjesëmarrje në Trajnime**

### **Në kuadër të projektit “Ftesë për Pjesëmarrje: “Fuqizimi i Qeverisjes së Migracionit dhe Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Kosovë”” – Financuar nga GIZ dhe implementuar nga ECMI Kosova**

**ECMI Kosovo** ka kënaqësinë të shpallë thirrjen për pjesëmarrje në një seri trajnimesh që synojnë forcimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (CSOs) dhe institucioneve për të përmirësuar qeverisjen e migracionit dhe të drejtat e punëtorëve migrantë në Kosovë.

### **Përshkrimi i Projektit**

**“Strengthening Migration Governance and Civil Society Capacities in Kosovo”** është një projekt i financuar nga GIZ dhe implementuar nga ECMI Kosova, që synon të fuqizoj kapacitetet e institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile për të fuqizuar qeverisjen e migracionit dhe të mbrojtë të drejtat e punëtorëve migrantë në Kosovë.

Projekti fokusohet në:

- Ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve publike për rekrutim etik, transparencë kontratash dhe zbatimin e të drejtave të punëtorëve;
- Fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile për të advokuar, monitoruar dhe ndihmuar punëtorët migrantë;
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave për të adresuar sfidat e migracionit.

Kjo iniciativë është pjesë e përpjekjeve për të krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të menaxhimit të migracionit, duke përmirësuar mbrojtjen sociale dhe ekonomike për të gjithë aktorët e përfshirë.

### **Kush mund të aplikojë?**

Ftojmë të gjitha organizatat e shoqërisë civile dhe OJQ-të që:

- Kanë përvojë ose interes në çështjet e të drejtave të punëtorëve, migracionit ose grupeve të cënueshme;
- Janë të gatshme të angazhohen në aktivitete advokimi dhe monitorimi;
- Operojnë në Kosovë dhe dëshirojnë të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të punëtorëve migrantë.

## Çfarë ofrojnë trajnimet?

- Sesiione trajnuese profesionale mbi:
  - Praktikata e rekrutimit etik;
  - Transparenca dhe ndjekja e kontratave të punës;
  - Ligjet dhe politikat mbi të drejtat e punëtorëve migrantë;
  - Avokimi dhe monitorimi i kushteve të punës.
- **Përvojë praktike:** Simulime dhe raste studimi për të zbatuar njohuritë në situata reale.
- **Materiale mbështetëse:** Udhëzime, manuale dhe mjete për të ndihmuar organizatat në punën e tyre të përditshme.
- **Mbështetje financiare:** Mundësi për të përfituar nga programi i financimit për OShC-të për projekte advokimi dhe monitorimi.
- **Rrjetëzim dhe bashkëpunim:** Mundësi për të krijuar partneritete të reja me institucione qeveritare dhe organizata të tjera lokale dhe ndërkombëtare.
- **Trajnim i vazhdueshëm:** Mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve përmes një qasjeje të qëndrueshme si pjesë e projektit.

Këto trajnime nuk janë të kufizuara vetëm në temat e përmendura më sipër, por përfaqësojnë vetëm disa nga shumë tematika të tjera që do të trajtohen gjatë trajtimeve në kuadër të projektit. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të diskutojnë çështje të ndryshme relevante për fuqizimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e efikasitetit në fushat e qeverisjes së migracionit dhe mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve migrantë.

## Kriteret e përzgjedhjes

- Pjesëmarrësit duhet të jenë përfaqësues të organizatave aktive në çështje sociale, me përvojë ose interes në advokimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë.
- Organizatat e interesuara duhet të dërgojnë një **CV të organizatës**.

## Si të aplikoni?

Për të aplikuar, ju lutemi dërgoni informacionin e kërkuar në adresën e emailit [info@ecmikosova.org](mailto:info@ecmikosova.org) deri më **27.01.2025**

Nëse keni pyetje apo ju nevojiten informacione shtesë, mund të na kontaktoni në:

- **Email:** [info@ecmikosova.org](mailto:info@ecmikosova.org)
- **Telefon:** 045-815-135

**Afati i aplikimit:**

**13.01.2025 deri me 27.01.2025**

Ju falënderojmë për interesimin dhe ju mirëpresim të bëheni pjesë e kësaj iniciative që synon të përmirësojë qeverisjen e migracionit dhe të drejtat e punëtorëve migrantë në Kosovë!

Me respekt,  
**ECMI Kosovo**